



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:179999

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05445807

Ac.nr.6684/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Adnan Konushevci, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit M.H, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër debitorit SHSKUK-QKUK, në Prishtinë, objekt i përmbartimit kërkesë e mjeteve monetare, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.3125/20, i datës 06.07.2022 me datë 13.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit SHSKUK-QKUK, në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.3125/20, i datës 06.07.2022, **PRISHET** dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.3125/20, i datës 06.07.2022, e ka hedhur prapësimin e debitorit SHSKUK-QKUK, në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrin përmbartimor, P.nr.2680/20, i datës 16.10.2020 i Përmbartuesit Privat Afet Mjeku, si të pasafatshëm.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka parashtruar debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, aplikimi të gabuar të normave materiale si dhe konstatimi të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta anuloj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas se cilit hudhet poshtë si i pasafatshëm prapësimi i debitorit, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.2680/20, i datës 16.10.2020, si të pa argumentuara dhe i pa bazuar në dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP), ndërsa në këtë çështje

përmbartimore të vendos në mënyrë meritore ose t'ia kthej gjykatës së instancës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur nga kreditori.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të LPP-së), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim pranë organit përmbartues me datë 16.10.2014. Organi përmbartues me urdhrin, P.nr.2680/20, i datës 16.10.2020, e ka lejuar përmbartimin.

Debitori në afatin ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin të organit përmbartues me propozim që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.3125/20 i datës 06.07.2022, e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se debitori e ka parashtruar prapësimin pas afatit ligjor të paraparë me nenin 70 të LPP-së, ndërsa vërtetohet se prapësimi është dorëzuar te organi përmbartues me datë 30.10.2020 (sipas vulës së pranimit te përmbartuesit privat në prapsim), dhe nga kjo rezulton se prapësimi është ushtruar pas skadimi të afatit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, si dhe nenin 127 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se nuk është zbatuar drejtë e drejta materiale.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të debitorit të parashtruara me ankesë gjeti se të njëjtat janë të themelta. Kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe të procedurës përmbartimore, duke mos i zbatuar si duhet dispozitat ligjore, e si rezultat i kësaj ka çuar edhe te marrja e një vendimi të pa qëndrueshëm dhe kundërligjor.

Gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me përfundimin se prapësimi është parashtruar pas afatit të paraparë ligjor, pa i vlerësuar mirë të gjitha shkresat që gjenden në lëndë dhe pa vërtetuar saktë se në çfarë mënyre e ka dorëzuar prapësimin debitori tek përmbaruesi privat, përmes postës apo drejtpërdrejtë në zyrën e përmbaruesit apo eventualisht i njëjti a ka pasur ndonjë arsye se përse ka ardhur deri mos paraqitja e prapësimit nga ana e debitorit.

Nga shkresat e lëndës për Gjykatën e Apelit, rezulton të provohet se procedura për përmbarim nuk është bërë në përputhje me dispozitat ligjore, më konkretisht me dispozitat e LPK-së, të cilat e rregullojnë mënyrën e dorëzimit të shkresave si është paraparë me nenin 127 të LPK-së.

Neni 127.1 i LPK-së përcakton se: *“Kur parashtrësa është e lidhur me afat, konsiderohet se është parashtruar me kohë, po që se i është dorëzuar gjykatës para se të ketë mbaruar afati”*, paragrafi 2 i po këtij neni përcakton 127.2 *“Në qoftë se parashtrësa është dërguar me anë të postës me letër rekomande apo në rrugë telegrafike, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatën të cilës i është drejtuar. Po që se parashtrësa është dërguar me anë të telefaksit si ditë e dorëzimit konsiderohet dita kur telefaksi është pranuar në gjykatë”*. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë në këtë rast ka vendosur në kundërshtim me dispozitën e sipërcituar, për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton se prapësimi është i afatshëm, dhe njëjti nga debitori është dorëzuar me postë me rekomande R-2212144, me datën 28.10.2020, nga kjo del se prapësimi nga ana e debitorit është paraqitur brenda afatit 7 ditor. Duke pasur parasysh këtë gjendje të krijuar, Gjykata e Apelit vlerëson se një vendim i tillë i gjykatës së shkallës së parë, nuk mund të qëndrojë dhe të vërtetohet si vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Në ri-procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në përputhje me vërejtjet e dhëna nga kjo Gjykatë, ashtu që fillimisht të eliminoj shkeljet e bëra gjatë procedurës, të vlerësojë se afatshmërinë e prapësimit dhe përmbajtjen e tij, të vendos në meritat e lëndës e pastaj të marr vendim meritor duke iu përmbajtur dispozitës së nenit 160 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6684/2022 të datës 13.03.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci